



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
DREJTORIA JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE**

Nr. 1430/ Prot

Tiranë, më 03/06 /2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

**DREJTORISË SË MARRËDHENIEVE ME PUBLIKUN**

**KËTU**

**DREJTORISË RAJONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT  
DHE AFTËSIVE, KUKËS**

Në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit nr.164, datë 05.10.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr.560, datë 26.07.2024 “Për mënyrën e emërimit, transferimit dhe lirimimit nga detyra të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës”, dhe shkresës me nr.268 prot, datë 28.05.2026 “Kërkesë për shpallje vendi të lirë pune” të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Kukës, protokolluar në AKPA me nr.1430 prot, datë 01.06.2026, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në faqen elektronike zyrtare të AKPA-s, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Kukës, brenda datës 04.06.2026, si më poshtë:

**Pozicioni i punës:**

Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Kukës (vetëm për periudhën kohore të lejes së barrë lindjes të specialistit të emëruar në këtë pozicion).

**1. Kriteria të përgjithshme:**

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- ç) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

## **2. Kritere të posaçme:**

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare “Bachelor” në Shkenca Juridike.
- b) të ketë njohuri të përditësuara të teknologjisë së informacionit.
- c) njohja e një gjuhe të huaj përbën avantazh.

## **3. Dokumentet e aplikimit:**

- a) letër motivimi për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën nr.1 të Udhëzimit të Ministrisë të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr.560, datë 26.07.2024 “Për mënyrën e emërimit, transferimit dhe lirimit nga detyra të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës”;
- c) kartën e identitetit;
- ç) diplomën dhe listën e notave;
- d) librezën e punës (nëse ka eksperiencë pune);
- dh) çdo dokumentacion tjetër, që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim (nëse ka);
- e) certifikatë/a ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- ë) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g) vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që nuk ka masë disiplinore në fuqi (nëse ka eksperiencë pune);
- gj) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësit e mëparshëm (nëse ka eksperiencë pune).

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, si dhe të jenë të noterizuara.

Njoftimi bëhet në faqen elektronike zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Kukës.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të Drejtorisë Qendrore të AKPA-s, brenda datës 12.06.2026.

Struktura e vlerësimit të kandidatëve fitues në fazën e dytë zhvillohet si më poshtë:

- Vlerësimi për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë i ndarë në:
  - i. arsimimi: 20 pikë;
  - ii. njohuritë në fushën e TIK- ut: 20 pikë;
- Vlerësimi për kriteret e tjera nëpërmjet intervistës me gojë është 60 pikë;
- Komisioni për intervistën e strukturuar me gojë zgjedh një grup të njëjtë pyetjesh të bazuara në kompetenca, për të gjithë kandidatët.
- Në intervistë, ndër të tjerat, kandidati vlerësohet për:
  - a. Ligji nr.15/2019 "Për nxitjen e punësimit" i ndryshuar;
  - b. VKM nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive" i ndryshuar
  - c. Ligji nr. 7961 date 12/7/1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar;
  - d. Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat";
  - e. Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
  - f. Legjislacioni mbi prokurimin publik.
- ii. motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;
  - Komisioni mbledh pikët dhe liston kandidatët sipas pikëve.
  - Minimumi i pikëve për t'u kualifikuar është 70 pikë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Klevis HËSA**

